



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 31.3.2022, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Blerina Gjylameti – zëvendëskryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i propozimit të një grupi deputetësh për zgjedhjen e një anëtari të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, të zotit Mateo Spaho.

Marrin pjesë:

Blerina Gjylameti, Sorina Koti, Arbi Agalliu, Emilja Koliqi, Edmond Spaho, Benet Beci, Erion Braçe, Alban Xhelili, Vullnet Sinaj, Pranvera Resulaj, Antoneta Dhima, Blerina Gjylameti, Dashamir Shehi, Shpresa Marnoj, Bujar Leskaj, Jorida Tabaku dhe Etjen Xhafaj.

Mungojnë:

Eduard Shalsi, Alfred Rushaj dhe Agron Shehaj.

HAPET MBLEDHJA

Blerina Gjylameti – Të nderuar kolegë, përshëndetje!

Këtë mbledhje e kemi në kuadër të vendimit të seancës plenare për ndryshimin e rendit të ditës, ku do të shqyrtojmë kandidaturën e zotit Mateo Spaho, i cili vjen si propozim i mbështetur nga 28 deputetë të opozitës për kandidaturën e tij si anëtar i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

Në radhë të parë, duhet të sqarojmë disa elemente që kanë të bëjnë me faktin e procedurave të respektuara deri më tani nga ana e të gjithë komisionit dhe shqyrtimit të tyre, në bazë të nenit 44 dhe 111 të Rregullores së Kuvendit, për pjesën e shqyrtimit të kandidaturave. Zotin Spaho e kemi pasur në dëgjese, ku i është përgjigjur pozitivisht thirrjes për vendet vakante të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

Prezente keni dosjen e tij, pra për të gjithë ata që kanë nevojë ta rishqyrtojnë. Nga ana e Shërbimit të Monitorimit të Kuvendit ka ardhur pjesa e analizës në përmbushje të kriterëve ligjore profesionale në lidhje me kandidaturën përkatëse. Dokumentacionin, pra depozitimi i nënshkrimit për mbështetjen e kandidaturës, ne e kemi këtu prezent me 28 firmat dhe me shkresën përkatëse, po ashtu, edhe dosjen e kandidatit. Lidhur me pjesën e kriterëve ligjore dhe profesionale, zoti Spaho e ka përditësuar dhe nënshkruar CV-në e tij. Ndërkohë, në CV-në e tij shikojmë që ai ka përfunduar studimet baçelor për ekonomi-financë. Po ashtu, ka përfunduar masterin për financë dhe menaxhim risku në vitin 2010 në universitetin e Parmës, ka përfunduar studimet për doktoraturë në vitin 2014 dhe në vitin 2015 ka marrë titullin “Profesor i asociuar” pranë Universitetit Bujqësor të Tiranës.

Në lidhje me dokumentacionin që ka dorëzuar, përmbush kriterin ligjor për pjesën e çështjeve financiare. Zoti Spaho ka një përvojë profesionale, e cila është 2 vjet e 6 muaj në administratën publike dhe nuk e plotëson kriterin bazë të kualifikimit të kandidaturave që duhet të jetë 5 vjet eksperiencë në pjesën e fushave profesionale financiare, bankare apo edhe në administratën publike. Në bazë të informacionit që ne kemi edhe nga Shërbimi i Monitorimit, zoti Spaho nuk e plotëson kriterin profesional për t’u kualifikuar nga Komisioni i Ekonomisë për t’i kaluar më pas seancës plenare.

Nëse keni diçka për të shprehur ose ndonjë pyetje, kolegë, fjala është për ju që të vazhdojmë ta diskutojmë.

Arbi Agalliu – Zoti Spaho ka ardhur në seancën dëgjimore që ne kemi bërë si komision me të gjithë kandidatët. Pyetja ime është: nëse zoti Spaho nuk plotësonte një nga kriteret, pse do të duhej të vinte që ta dëgjonim, të diskutonim dhe ai të shpaloste platformën e tij? Pra, cila është arsyeja?

Blerina Gjylameti – Atëherë, nga procedura që ne kemi në komision, i kemi dëgjuar të gjithë ata që plotësojnë kriterin formal bazë, pra për pjesën e formimit e me radhë. Më pas Komisioni i Ekonomisë, pasi i ka dëgjuar të gjitha kandidaturat, platformën dhe vizionin e tyre, ia ka kaluar për shqyrtim Shërbimit të Monitorimit për të marrë informacion nëse të gjitha kandidaturat janë në përmbushje të kriterit ligjor profesional. Ky material që ne kemi këtu, nuk na vjen sot për herë të parë, e kemi pasur të gjithë në *email*-et tona zyrtare që në dhjetor, kur kemi përfunduar dëgjuesën për të gjitha kandidaturat. Në këtë aspekt, nëse do të duhet ta ndryshojmë më pas procedurën që t'i skualifikojmë kandidatët para se të vijë në dëgjuesë ata që nuk i plotësojnë kriteret, kjo është diçka që do të duhet ta shikojmë dhe të ndryshojmë Rregulloren e Kuvendit.

Në bazë të Rregullores së Kuvendit, në mos gaboj, neni 44, pika 3, ne i shqyrtojmë kandidaturat, më pas i kalojmë në përzgjedhje në momentin që do të duhet të plotësojmë edhe pjesën e mbështetjes me 28 firma nga deputetët për t'u kaluar seancave plenare. Kështu që, në këtë aspekt, do të duhet të kalojmë, zoti Agalliu, në një ndryshim të Rregullores në të ardhmen, por sot që flasim, nuk e kemi këtë hapësirë.

Arbi Agalliu – Unë kam një propozim, nëse mundem.

Gjithsesi, në logjikën time, nuk shkon që komisioni të harxhojë kohë me një kandidat që juridikisht nuk vjen dot në votim, sepse është e kotë se nuk ka për çfarë të vijë. Pse duhet të vijë? Për t'i bërë PR vetes, për të na harxhuar në kohën?! Kështu, ndoshta do të duhet ndonjë jurist që ta sqarojë mirë këtë pjesë nga ana e procedurës. E para, unë nuk jam jurist, nuk e di dhe nuk mund ta them.

E dyta, për aq kohë sa edhe nga kryetari i grupit tuaj parlamentar pati një bonsens dhe konsensus që opozita të përfaqësohet me një kandidat, atëherë ne nuk shkojmë në votim sot në seancë dhe hedhim si propozim për të paraqitur në një emër tjetër, për aq kohë sa sot del që personi, që ka ardhur nga Shërbimi i Monitorimit të Kuvendit, nuk i plotëson kriteret.

Blerina Gjylameti – Zoti Spaho ka kërkuar fjalën.

Më pas zonja Dhima dhe zoti Leskaj.

Edmond Spaho – Dua të ngre dy probleme.

Së pari, mendoj se zoti Agalliu ka të drejtë kur thotë pse duhet t'i dëgjojmë ne në komision ata, të cilët nuk i plotësojnë kriteret minimale. Kështu që, në këtë kuptim, departamenti që mbledh kandidaturat, duhet që t'i shqyrtojë dhe të shikojë kush i plotëson kushtet, kush nuk i plotëson dhe nuk ka arsye t'i dëgjojmë ata që nuk i plotësojnë kushtet.

Problemi i dytë që dua të ngre, është që në traditën e Kuvendit për institucionet e pavarura, siç është rasti i Bankës së Shqipërisë, ne jemi përpjekur të ruajmë raporte përfaqësimi, aq sa ka qenë e mundur. Kështu që edhe në këtë rast gjykoj se duhet marrë në konsideratë edhe opozita që të kishte një përfaqësim, madje jo vetëm me kandidaturë, por ne kemi rënë gjithmonë dakord që do të votojmë këtë nga maxhoranca, do të votojmë edhe këtë nga opozita, në mënyrë që të sigurojmë te bordi mbikëqyrës përfaqësimin e spektrit politik shqiptar në linjat kryesore. Kështu, mendoj se në të ardhmen duhet t'i kthehemi kësaj praktike, sepse, edhe sikur ne të propozojmë një tjetër, për sa kohë që këta do të votojnë ato dy kandidatura, kjo është e mbyllur dhe ne rrimë e bëjmë lojërë; kjo nuk vlen. Vlen që opozitës t'i thuhet: duhet të kesh një kandidaturë, kështu që silli njerëzit, që i plotësojnë kriteret, dhe të konkurrojnë si gjithë të tjerët. Unë mendoj se kjo është mënyra që duhet ta trajtojmë në të ardhmen plotësimin e vendeve në institucionet e pavarura.

Faleminderit!

Antoneta Dhima – Komisioni për Ekonominë dhe Financat i ka ezauruar të gjitha procedurat, ka bërë dëgjesa me gati 17 kandidatë. Ne kemi një raport, i cili është depozituar pranë komisionit që në dhjetor të vitit 202; besoj se të gjithë anëtarët e komisionit e kanë parë. Personi, për të cilin ne po diskutojmë, është mbështetur nga ana juaj me 28 firma. Sipas procedurës ligjore dhe sipas rekomandimit që shërbimi i Kuvendit ka bërë, brenda 3 javëve nga marrja e tyre vendos, nëse kandidaturat i plotësojnë kushtet ligjore, normalisht shkojnë në seancë plenare. Ne e kemi ezauruar këtë pjesë, ku Partia Socialiste ka mbështetur dy kandidatë, ndërsa ju keni mbështetur një kandidat. Kandidati i propozuar nga ana juaj nuk i plotëson kriteret, ndaj ju i kishit të gjitha mundësitë që brenda kësaj 17-shes, duke përjashtuar dy kandidatët që janë propozuar dhe janë mbështetur me 28 firma nga ana juaj, të kishit mundësi të zgjidhnit një kandidat, i cili i plotësonte kriteret. Ju nuk e keni ezauruar këtë gjë, ndaj jemi në kushtet që personi, i cili është propozuar nga ana juaj dhe është mbështetur me 28 firma nuk i plotëson kriteret dhe ne diskutojmë kot. Për ta përmirësuar procedurën në një moment tjetër, kur të shpallen vakanca të tjera, patjetër që ne do t'i reflektojmë këto kërkesa dhe këto propozime nga ana juaj, por tani jemi në kushtet që kandidati i

propozuar nga ana juaj nuk i plotëson kriteret, ndaj, zonja Gjylameti, unë mendoj që ne të kalojmë në votim.

(Diskutime pa mikrofon.)

Blerina Gjylameti – Faleminderit, zonja Dhima!

Po, zoti Leskaj.

Bujar Leskaj – Unë po ju kërkoj ndjesë në fillim, se dua të bëj dy vërejtje që janë të vonuara.

E para, ne vazhdojmë të bëjmë një gabim në konceptim. Ne nuk duhet të ecim me logjikën dy kandidatura pozita, dy kandidatura opozita. Në institucione të tilla që, sipas ligjit kërkohen të jenë të depolitizuara, ne duhet të kalojmë në praktikën që duhet të propozojnë dhe të firmosin 28 deputetë të Kuvendit të Shqipërisë, jo të partive politike, siç e kërkon ligji dhe Rregullorja. Ne që në momentin e parë e bëjmë këtë ndarje dhe i vëmë në pozitë edhe kur janë kandidatura tejet profesioniste, siç janë të tria këto kandidatura që do të kalojmë sot.

E dyta, unë mendoj se ne duhet ta lejojmë zotin Spaho të kandidojë dhe duhet t'i bëjmë një interpretim kriterit që të ketë mbi 5 vjet përvojë pune në administratën publike ose në institucionet financiare dhe bankare. Pra, për hir të CV-së së tij që ai ka mbi 5 vjet përvojë në mësimdhënie dhe është i specializuar në këto lëndë, ne duhet ta lejojmë të kandidojë dhe duhet të shikojmë një modalitet, nuk duhet të jemi striktë. Madje, unë, personalisht, po të isha treguar i vëmendshëm, ky është gabimi im, jo juaji, mund të kërkoja edhe përmirësim ligjor. Nuk ka kuptim që ne të vendosim kushtin 5 vjet përvojë në administratën publike dhe të përjashtojmë ata individë që në këta 5 vjet kanë qenë pedagogë në mësimdhënie në universitete, sepse do të kemi edhe raste të tjera. Për mendimin tim, këtë gjë duhet ta shikojmë, që, në rast se ka vend për interpretim, ta lejojmë të votohet. Nga ana tjetër, unë rikonfirmoj që ne ta zhvillojmë sot votimin për të dyja këto kandidatura, të cilat janë dinjitoze. Zonja Ahmetaj, nuk është marrë fare me politikë në këta 30 vjet të pluralizmit në Shqipëri dhe është profesioniste. Sinqerisht, për këtë rast më vjen keq, sepse ju mund të siguronit edhe firmat tona, të paktën firmën time personale bashkë me 28 firmat e tjera. Të njëjtën gjë mund të them edhe për zotin Angjeli, ndaj nuk duhet t'i pengojmë dhe jam kundër këtij trajtimit: një nga ju apo një nga ne.

Ndjesë se u zgjata.

Blerina Gjylameti – Atëherë, a kemi ndonjë shqetësim tjetër apo ndonjë mendim?

Benet Beci – A mund të them diçka?

Blerina Gjylameti – Po.

Benet Beci – Unë i dëgjova me vëmendje kolegët, gjithashtu, i dëgjova me vëmendje Edmondin dhe Bujarin. Praktikisht jam dakord me Edmondin kur tha që tani nuk ka më kohë të propozojmë kandidatura të tjera dhe ta shtyjmë edhe procedurën e votimit. Lidhur me atë që tha Bujari, nuk jam dakord realisht. Pse nuk jam dakord që ne t’i rishikojmë kriteret? Nuk jam dakord, sepse do t’u hynim në hak të gjithë qytetarëve shqiptarë që aplikojnë për një pozicion pune dhe nuk e kanë mundësinë që të trajtohen në një formë ndryshe nga përcaktimi ligjor. Kur kriteri e përcakton 5 vjet, atëherë është 5 vjet. Ne këtu kemi mundësi që ta mbrojmë kandidaturën dhe të themi që ai i plotëson disa kriteret, por të gjithë ata qytetarë shqiptarë, të cilët aplikojnë në disa pozicione pune dhe nuk u jepet kjo mundësi mbrojtjeje, si do t’ia bënin? Atëherë, duhet që t’i vendosim një fuqi paravepruese të gjitha propozimeve që mund të vijnë lidhur me këto kriteret dhe për këtë unë nuk jam dakord. Unë mendoj që kandidatura, për sa kohë që nuk i plotëson kriteret, nuk mund të kalojë.

Faleminderit!

Blerina Gjylameti – Atëherë, sipas procedurave dhe Rregullores së Kuvendit, së pari, ne bëjmë dëgjesën.

Pra, në Rregullore është e përcaktuar që, së pari, bëhet dëgjesa publike me të gjithë kandidatët, që kanë shprehur dëshirën për të aplikuar.

Së dyti, pasi janë mbështetur me 28 firma, sipas nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, i kalohen komisionit për të bërë vlerësimin e kriterëve. Komisioni thërret Shërbimin e Monitorimit të Kuvendit për të parë përmbushjen e kriterëve formale, pra kriterëve ligjore dhe profesionale në fushë, më pas ne bëjmë vlerësimin për t’ia kaluar seancës plenare për votim.

Unë jam e bindur, sipas diskutimeve që kemi pasur gjithmonë në komision, dhe nuk janë vetëm diskutimet e sotme, se ka hapësira për të përmirësuar të gjitha procedurat në të ardhmen. Sot jemi në këtë fakt dhe duhet të marrim një vendim për faktin përkatës. Ndërkohë, për rastin konkret unë besoj se duhet t’u qëndrojmë striktë ligjit, procedurave dhe Rregullores së Kuvendit. Në të ardhmen duhet që së bashku, pasi kemi bërë edhe diskutime të tjera për ndryshime në Rregullore për përmirësim të procedurave, të jemi drejt thirrjes së kandidatëve, të cilët mund të jenë shumë të aftë profesionalisht, por mund të kenë një kriter, ndonjëherë edhe diskriminues, sikundër është edhe kandidati përkatës, i cili ka një eksperiencë të gjatë në fushën e mësimit dhe sidomos në pjesën bankare.

Ndërkohë, do t'ju lutesha që të mos vijojmë përsëri të diskutojmë atë çfarë do të duhet të jetë në të ardhmen. Ne sot mund të ulemi, si Komision i Ekonomisë, dhe duhet të jemi në seancë...

Bujar Leskaj – A mund të bëj një ndërhyrje?

Blerina Gjylameti – Zoti Leskaj, nuk e përfundova!

Tani jam në momentin që do ta hedhim në votim për të vendosur se çfarë do të bëjmë.

Atëherë, kush është dakord...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Unë e mbylla tani dhe kjo nuk shkon...

(Diskutime pa mikrofon.)

Kush është dakord që zoti Spaho, pavarësisht se nuk i plotëson kriteret formale ligjore, t'i kalojë seancës për votim? 6 vota pro. Kundër? 10 vota kundër. Abstenim? Nuk ka.

Kandidatura nuk miratohet për t'i kaluar seancës plenare.

Faleminderit, kolegë!

Mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

MBYLLET MBLEDHJA

Sekretare e komisionit

Enslemvera Zake

Përgjegjësjë e Shërbimit të Redaktorëve

Euzheni Pengili

Sekretar Administrariv

Elvi Prifti